



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 26 maj 2023

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të rregullit 19 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2018; si dhe në mbështetje të Rregullores nr. 06/2022 për ndryshimin e plotësimin e Rregullores nr. 02/2022 për punën praktike në Gjykatën Kushtetuese, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpall

SHPREHJEN E INTERESIT
për angazhimin e një praktikanti

Pozita: Praktikant për Multimedia dhe Ueb-faqe

Numri i pozitave: 1 (një)

Kohëzgjatja e praktikës: Një (1) vit

Detyrat kryesore

Nën mbikëqyrjen e drejtorit të Zyrës për Komunikim dhe Informim (ZKI), Praktikanti për Multimedia dhe Ueb-faqe, ndihmon ZKI-në rreth monitorimit të shkrimeve dhe video-materialeve informative në mediat/rrjetet sociale përkitazi me punën e Gjykatës, menaxhimit të sektorit të njoftimeve në ueb-faqen e Gjykatës dhe me faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale, përgatitjes dhe publikimit të video-materialeve informative në ueb-faqen dhe në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale, dhe identifikon mundësitë për promovimin e punës së Gjykatës në mediat/rrjetet sociale.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Të ndihmojë ZKI-në në monitorimin e video-materialeve informative të publikuara në mediat/rrjetet sociale përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës;
2. Të ndihmojë ZKI-në në përgatitjen e raporteve periodike përkitazi me çështjet e trajtuara në mediat/rrjetet sociale rreth punës dhe aktiviteteve të Gjykatës;
3. Të ndihmojë ZKI-në në postimin dhe përditësimin e njoftimeve përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës Kushtetuese në ueb-faqen dhe në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;
4. Të transmetojë drejtpërdrejtë konferencat për shtyp, seancat dëgjimore, video-intervistat dhe video-materialet tjera informative në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale, në konsultim me drejtorin e ZKI;
5. Të ndihmojë ZKI-në në përgatitjen dhe disenjimin e tabelave statistikore dhe video-materialeve informative të metrazhit të shkurt/gjatë përkitazi me punën dhe aktivitetet e Gjykatës, dhe promovimin e tyre në faqet e Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;

6. Të identifikojë mundësitë dhe të hartojë propozime për promovimin e punës dhe aktivitetëve të Gjykatës në mediat/rrjetet sociale;
7. Kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së drejtorit të ZKI.

Kualifikimet dhe aftësitë

1. Të drejtë aplikimi për pozitën e praktikantit kanë të gjithë kandidatët që:
 - i. janë shtetas të Republikës së Kosovës;
 - ii. kanë zotësi të plotë për të vepruar;
 - iii. zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, si dhe kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;
 - iv. kanë diplomuar në shkencë sociale, ekonomi ose të ngjashme, në njërin nga universitetet në Kosovë, kanë diplomë të fakulteteve të shkencave sociale, të ekonomisë ose të ngjashme, të nostrifikuar në Kosovë, ose janë në vitin e fundit të studimeve në fakultete të shkencave sociale, ekonomi ose të ngjashme; dhe
 - v. demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike (njohja e programeve si: Adobe Photoshop, Adobe Premier, Adobe Illustrator, Canva dhe të ngjashme, është përparësi).

Informata të përgjithshme për kandidatët

Shuma e kompensimit material të praktikantëve do të jetë ekuivalente me pagën minimale në Republikën e Kosovës në vitin e angazhimit të praktikantit;

Para kalimit të afatit kohor për të cilin janë pranuar në Gjykatë, praktikantët i nënshtrohen vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike.

Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, praktikanti pajiset me certifikatë me të cilën dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Gjykatë.

Gjykata ofron mundësi të barabarta të angazhimit për gjithë kandidatët aplikues.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës të Gjykatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të dorëzohet në postën elektronike: gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data **29 maj 2023** deri më datën **12 qershor 2023**, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 12 qershor 2023, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.